

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 8 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 11¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 60 paragrafi (4) dhe neni 91 paragrafi (4) nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 7 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 11 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.023712/2 datë 12.09.2024, miratuar në seancën e 35-të mbajtur më 12.09.2024, është përcaktuar Tekst i pastruar i Rregullores për veprat audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur.

Teksti i pastruar i Rregullores për veprat audiovizivi evropiane dhe vepra nga prodecentë të pavarur, përfshin: Rregulloren për transmetimin e veprave audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur nr.01-5977/1 datë 04.12.2014 dhe Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për transmetimin e veprave audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur nr. 01-3750/1 datë 13.09.2024.

RREGULLORE PËR VEPRA AUDIOVIZIVE EVROPIANE DHE VEPRA NGA PRODUCENTË TË PAVARUR (Tekst i pastruar)

Neni 1

Objekt i Rregullores

Kjo Rregullore përcakton mënyrën se si transmetuesit që kryejnë veprimtari në nivel shtetëror në shërbimet e tyre programore televizive duhet të sigurojnë përfaqësim të veprave audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur, si dhe mënyrën se si ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës do të sigurojnë pjesëmarrjen dhe shikueshmërinë e veprave evropiane në katalogun e programeve, shmangja nga ky detyrim dhe dokumentet që duhet t'i dorëzohen Agjencisë.

Kjo Rregullore nuk i referohet detyrimit të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizivi sipas kërkesës për të promovuar prodhimin dhe qasjen në vepra audiovizivi evropiane, nga neni 60 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive.

Neni 2

Përkufizimet

Disa shprehje të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. Veprat audiovizivi evropiane janë veprat e përcaktuara në nenin 3 paragrafi (1) nënparagrafi 9 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të cilat e kanë origjinën

nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nga vendet e treta evropiane nënshkruese të Konventës për televizionin ndërkufitar? të Këshillit të Evropës ose janë prodhuar në kuadër të marrëveshjeve në lidhje me sektorin audioviziv të lidhura ndërmjet BE-së dhe vendeve të treta;

2. Veprat audiovizive maqedonase janë vepra origjinale të prodhuara nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjuhën maqedonase, si dhe vepra origjinale të

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18)

prodhuara nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjuhët e bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe vepra të trashëgimisë kulturore në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

3. Veprat e trashëgimisë kulturore audiovizive në RMV-së janë audiovizive të mira dhe fonografike të mira që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore të RMV-së dhe janë të destinuara për ekspozim publik;

4. Veprat audiovizive nga prodhim vendas janë vepra të krijuara me iniciativë dhe nën organizimin e vetë transmetuesit, vepra të porositura nga transmetuesi (produksion i porositura) ose të prodhuara në koproduksion.

5. Producent i pavarur është personi fizik ose juridik që ofron produksion të veprave audio ose audiovizive, me kusht që:

_ të mos ketë pjesë në kapitalin e transmetuesit më shumë se 25% dhe _ transmetuesi të mos ketë pjesë në kapitalin e producentit.

6. Katalogu është orar i përmbajtjeve mediatike audiovizive në bazë të dhënash në mënyrë që ato të jenë të aksesueshme për përdoruesit.

Neni 3

Për cilat shërbime nuk vlen detyrimi?

Detyrimi për të siguruar përfaqësim të veprave audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur, nuk referohen për:

_ shërbimet programore televizive dedikuar në veçanti për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklama, teleshoping dhe teleteks shërbime dhe _ të gjitha shërbimet programore televizive të Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup, me përjashtim të televizionit të maqedonisë - Shërbimi i parë programor, për të cilin vlen ky detyrim.

Neni 3-a

(1) Detyrimi nga neni 60, paragrafi (1) nga Ligji nuk do të zbatohet për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës me qarkullim të vogël, përkatësisht të ardhurat totale të realizuara nga sigurimi i shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës në vitin paraprak kalendarik ishte më pak se 5.000 euro në denarë ose me shikueshmëri të ulët përkatësisht:

_ numri mesatar i përdoruesve aktivë në vitin paraprak kalendarik ishte më pak se 1000, kur bëhet fjalë për shërbim sipas kërkesës që përdoret mbi bazën e pagesës së veçantë për çdo përmbajtje mediatike (TVOD); _ numri mesatar i (parapaguesve) abonentëve aktivë në vitin paraprak kalendarik ishte më pak se 1000, kur bëhet fjalë për shërbim sipas kërkesës që përdoret në bazë të abonimi mujor (SVOD).

(2) Numri mesatar i përdoruesve aktivë nga paragrafi (1) nënparagrafi 1 të këtij neni llogaritet si numri mesatar i përdoruesve të vetëm që realisht kanë marrë përmbajtje video me qira gjatë vitit kalendarik.

(3) Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës, të cilët konsiderojnë se i plotësojnë kushtet nga paragrafi (1) të këtij neni, janë të detyruar më së voni deri më 31 mars në Agjenci të paraqesin kërkesë për përjashtim, së cilës do t'i bashkëngjitin llogarinë përfundimtare dhe/ose dëshmi përkatëse për numrin e parapaguesve (abonentëve) në vitin paraprak.

(4) Ndaj kërkesës për përjashtim është e nevojshme të dorëzon dhe deklaratë të noterizuar, në të cilën personi përgjegjës me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale konfirmon se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta.

Neni 4

Cilat nuk konsiderohen si vepra audiovizive evropiane?

Në veprat audiovizive evropiane përfshihen të gjitha llojet e programeve të transmetuara nga radiodifuzeri, përveç lajmeve ose të përditshmet ditore në televizion; ngjarje sportive; lojëra (me përjashtim të kuizeve); transmetimet apo inçizimet e seancave të organeve qeveritare; transmetimet ose inçizimet e ngjarjeve socio-politike; shërbim informacioni; programe me horoskopë, tarot, fallxhorët ose interpretimin e ëndrrave; video muzikore; dhe përmbajtje që nuk i nënshtrohet klasifikimit të përcaktuar në pikën 17 të Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audiovizive dhe audio² (komunikime komerciale audiovizive; njoftime nga transmetuesi në lidhje me programet personale; njoftime me karakter publik; thirrje për qëllime bamirësie; intermeco; programe fetare, shërbime dhe predikime; programe për kulturë fizike dhe rekreacion; dhe spica hapëse dhe mbyllëse, xhigla dhe avizo).

Neni 5

Mënyra e llogaritjes së përfaqësimit të veprave audiovizive evropiane

Përqindja e veprave audiovizive evropiane llogaritet nga koha totale e cila gjatë vitit është ndarë për transmetim të llojeve të programeve që nuk përjashtohen në nenin 4 të Rregullores.

Në përqindje për vepra audiovizive evropiane llogariten vetëm dy transmetime të çdo vepre (premiera dhe përsëritja e parë) gjatë vitit, pavarësisht vitit të prodhimit.

Në vepra audiovizive evropiane përfshihen gjithashtu dhe vepra audiovizive të prodhuara nga vetë transmetuesi dhe vepra audiovizive maqedonase.

Neni 5-a Mënyra e sigurimit të pjesës dhe shikueshmërisë së veprave audiovizive evropiane në katalogun e programeve

(1) Përqindja e veprave evropiane në katalogët programorë të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të jetë së paku 30%.

(2) Gjatë llogaritjes së pjesës së veprave evropiane në katalog, nuk do të merret parasysh përmbajtja audiovizive e përmendur në nenin 6, si dhe përmbajtja pornografike.

(3) Pjesa e përmendur në paragrafin (1) do të llogaritet në bazë të numrit të titujve të veprave audiovizive në katalogun e programit, nga ku një titull përfaqëson:

-çdo film individual, „filma individualë nga e njëjta franshiz filmash dhe „një sezon

serialesh televizive dhe forma të tjera që shfaqen në një seri.

(4) Pjesën nga paragrafi (1) ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës janë të detyruar të realizojnë mesatarisht gjatë një viti kalendarik.

(5) Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës janë të detyruar veprat evropiane t'i nxjerrin në faqen e parë të katalogut të programit.

(6) Shikueshmëria adekuate e veprave evropiane në katalogun e programit mund të sigurohet në cilëndo nga mënyrat e mëposhtme:

² Udhëzim për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audiovizive dhe audio të publikuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 171/14

- kategori e veçantë në katalogun e programit të shënuar si "vepra evropiane", - mundësi për të kërkuar vepra evropiane përmes mjeteve të kërkimit të ofruara nga shërbimi,
- marketing i veçantë ose kampanjë promovuese e veprave evropiane, ose promovuese për veprat evropiane, ose
- mënyra të tjera inovative të mundësuar nga vetë shërbimi sipas kërkesës dhe mjetet e përdorimit dhe kërkimit që ai u ofron përdoruesve.

Neni 6

Përbushja progresive e detyrimit për veprat audiovizive evropiane

Shërbimet programore televizive që për herë të parë marrin leje për transmetim televiziv në nivel shtetëror pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, detyrimin për të përfaqësuar veprat audiovizive evropiane e përbushin në mënyrë progresive, në një periudhë 5-vjeçare, si më poshtë:

- në vitin e parë, përqindja e përfaqësimit të veprave audiovizive evropiane duhet të jetë së paku 10%, dhe
- në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt, përqindja e përfaqësimit të veprave audiovizive evropiane duhet të rritet me të paktën 10% në vit dhe në vitin e pestë duhet të jetë së paku 51%.

Neni 7

Detyrimi për vepra nga producentë të pavarur

Radiodifuzerët që transmetojnë shërbime programore televizive në nivel shtetëror janë të detyruar nga buxheti vjetor destinuar për programe (dhe për prodhim dhe për blerjen e programeve televizive), të ndajnë së paku 10% për vepra audiovizive evropiane të prodhuar nga producentë të pavarur, ku së paku gjysma e tyre janë prodhuar në pesë (5) vitet e fundit.

Neni 8

Detyrimi për regjistrim dhe sigurim të të dhënave

Radiodifuzerët që transmetojnë shërbime programore televizive në nivel shtetëror janë të detyruar të mbajnë evidencë ditore për veprat audiovizive evropiane të transmetuara dhe veprat e prodhuara nga producentë të pavarur gjatë vitit dhe jo më vonë se 31 mars të vitit pasardhës, të njoftojnë Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për përbushjen e këtyre detyrimeve në vitin kalendarik paraparak.

Të dhënat i plotësojnë në Formularin për veprat audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur përcaktuar nga Agjencia. Rishikimi i

vendeve, veprat audiovizive të të cilave kualifikohen si evropiane sipas kushteve gjeografike, janë pjesë përbërëse e formularit.

Së bashku me njoftimin, transmetuesit mund t'i paraqesin Agjencisë edhe çdo të dhënë tjetër cilësore për përpjekjet dhe sfidat me të cilat përballen në prodhimin, porositjen, blerjen dhe transmetimin e veprave audiovizive evropiane dhe vepra nga producentë të pavarur, si dhe për çdo iniciativë që kanë ndërmarrë ose planifikojnë të ndërmarrin për të përmbushur dispozitat e ligjit.

Neni 8-a

Sigurimi i të dhënave dhe dokumenteve për pjesën e veprave evropiane në katalogun e programit

(1) Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive me kërkesë janë të detyruar jo më vonë se 31 mars në vitin aktual, në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të dorëzojnë raportin për pjesën e arritur të veprave evropiane në katalogun programor në vitin paraprak. Raporti dorëzohet në formularin që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

(2) Në rastet kur ka dyshime për origjinën e saktë të përcaktuar të një vepre të caktuar audiovizive, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive me kërkesë janë të detyruar, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të paraqesin prova(dëshmi) dhe shpjegimin e arsyeve pse konsiderohet se vepra audiovizive është vepër evropiane. Si prova konsiderohen marrëveshjet për shpërndarjen e veprës audiovizive me poseduesit e të drejtave dhe bazat të besueshme të të dhënave, si bazat e të dhënave të Observatorit Evropian Audioviziv.

(3) Jo më vonë se 31 janari i vitit aktual, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive me kërkesë, janë të detyruar të njoftojnë Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për mënyrën në të cilën ata sigurojnë shikueshmëri adekuatë të veprave evropiane në katalogun e programit. Për çdo ndryshim në mënyrën e sigurimit të shikueshmërisë së duhur të veprave evropiane, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive janë të detyruar menjëherë të njoftojnë Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

(4) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizive mund të kërkojë kontroll në katalogun e programit çdo gjashtë muaj, me ç'rast ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive janë të detyruar që të dhënat t'i dorëzojnë në formularët e paraparë me këtë Rregullore dhe t'i bashkëngjisin dëshmitë përkatëse për të mbështetur të dhënat.

Neni 9

(Neni 9 i Rregullores për transmetimin e veprave audiovizive evropiane nga producentë të pavarur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.180/14)

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së vlefshmi Rregullorja për vepra audiovizive evropiane ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 133/2006).

Neni 10

(Neni 1 i Rregullores për transmetimin e veprave audiovizive evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 180/14)

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 11

(neni i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për transmetimin e veprave audiovizive evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur ("Gazeta Zyrtare e

Republika e Maqedonisë së Veriut” nr. 1 93/24)

Kjo Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për transmetimin e veprave audiovizive dhe vepra nga producentë të pavarur (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 180/14) hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe do të publikohet në ueb- faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

FORMULAR
PËR VEPRAT AUDIOVIZIVE EVROPIANE PËR ----- VITIN

(emri i ofruesit të shërbimit mediatic audioviziv sipas kërkesës)

I. Raport përmbljedhës

01.01 -31.12	
	Numri i titujve
Vepra audiovizive evropiane	
Numri i përgjithshëm i titujve në katalog	
Pjesa e pjesës evropiane në katalog në%	

II. Raport individual

1	2	3	4	5	6	7	8
Numri rendor i katalogut	Titulli në katalog	Titulli origjinal	Viti i prodhimit	Kategoria (film ose serial; nëse është serial, të tregoni se cila sezon është dhe numrin e episodeve)	Vendi i origjinës	Producenti (nëse ka, më shumë, të paraqiten të gjitha kompanitë e produksionit)	Shteti ku është selia e kompanisë së produksionit (nëse ka më shumë, të paraqiten të dhëna për çdo kompani produksioni)

III. Si shtojcë të Raportit, detyrimisht të dorëzohet edhe katalogu i përmbajtjes.

